

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitet 1991

Lënda Nr. IT-04-84-A

Data: 2 shtator 2009

Origjinali: anglisht

NË DHOMËN E APELIT

Para: Gjykatësit Patrick Robinson, Kryegjykatës
Gjykatësit Fausto Pocar
Gjykatësit Liu Daqun,
Gjykatëses Andrésia Vaz
Gjykatësit Theodor Meron

Sekretar: Z. John Hocking

Vendim i datës: 2 shtator 2009

PROKURORI

kundër

**RAMUSH HARADINAJT
IDRIZ BALAJT
LAHI BRAHIMAJT**

PUBLIK

**VENDIM NË LIDHJE ME KËRKESËN E LAHI BRAHIMAJT
PËR NDRYSHIMIN E KUSHTEVE TË LIRIMIT TË PËRKOHSHËM**

Zyrës së Prokurorit:

Z. Peter Kremer QC

Avokatëve të të Akuzuarve:

Z. Ben Emmerson QC dhe Z. Rodney Dixon për Z. Ramush Haradinaj
Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Collen Rohan për Z. Idriz Balaj
Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop për Z. Lahi Brahimaj

1. Dhoma e Apelit e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (përkatësisht “Dhoma e Apelit” dhe “Tribunali Ndërkombëtar”) është informuar për “Kërkesën në Emër të Lahi Brahimajt për Ndryshimin e Kushteve të Lirimit të Përkohshëm” dorëzuar prej Lahi Brahimajt (“Brahimaj”) më 31 korrik 2009 (“Kërkesa”). Zyra e Prokurorit (“Prokuroria”) dorëzoi Përgjigjen më 10 gusht 2009.¹ Brahimaj paraqiti Kundërpërgjigjen më 17 gusht 2009.²

I. RRETHANAT

2. Më 3 prill 2008, Dhoma Gjyqësore I (“Dhoma Gjyqësore”) shpalli Brahimajn fajtor për torturim dhe trajtim mizor si shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, bazuar në Nenin 3 të Statutit të Tribunalit,³ dhe e dënoi me gjashtë vjet burgim Aktualisht Dhoma e Apelit ka marrë apelet kundër Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore paraqitur prej Brahimajt dhe Prokurorisë.⁴

3. Më 18 mars 2009 Brahimaj paraqiti mocion për lirim të përkohshëm⁵ të cilit Prokuroria iu përgjigj më 25 mars 2009.⁶ Më 25 maj 2009, Dhoma e Apelit miratoi lirimin e përkohshëm bazuar në Rregullën 65(I) të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit (“Rregullorja”).⁷ Ndërmjet kushteve të lirimit të përkohshëm përcaktuar prej Vendimit Miratues të Lirimit të Përkohshëm, Dhoma e Apelit e urdhëronte Brahimajn që të informonte autoritetet e Misionit EULEX për Kosovën dhe Sekretarin e Tribunalit për adresën e banimit të tij në Kosovë para largimit të tij prej Njësisë së Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara në Hagë.⁸ Gjithashtu Dhoma e Apelit përcaktoi që Brahimaj duhet “të qëndrojë brenda kufijve të komunës ku banon” gjatë periudhës së lirimit të përkohshëm.⁹ Më 27 maj 2009, Brahimaj paraqiti një njoftim konfidencial ku bënte të ditur adresën ku do të qëndronte gjatë lirimit të

¹ Prosecution’s Response to Application on Behalf of Lahi Brahimaj to Vary Conditions of Provisional Release, 10 August 2009 (“Response”)/Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës në Emër të Lahi Brahimajt për Ndryshimin e Kushteve të Lirimit të Përkohshëm, 10 gusht 2009 (“Përgjigje”).

² Reply on Behalf of Lahi Brahimaj in Relation to Application [sic] to Vary Conditions of Provisional Release, 17 August 2009 (“Reply”)/Kundërpërgjigje në Emër të Lahi Brahimajt për Ndryshimin e Kushteve të Lirimit të Përkohshëm, 17 gusht 2009 (“Kundërpërgjigje”).

³ *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve.*, Lënda Nr.IT-04-84-T, Aktgjykim, 3 prill 2008 (“Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore”), para 504.

⁴ Njoftim për Apel në Emër të të Akuzuarit të Tretë, Lahi Brahimaj, 5 maj 2008; Njoftimi për Apel i Prokurorisë, 1 maj 2008.

⁵ Kërkesë për Lirim të Përkohshëm Dorëzuar prej të Akuzuarit Lahi Brahimaj, 18 mars 2009 (“Mocion për Lirim të Përkohshëm”).

⁶ Prosecution’s Response to Lahi Brahimaj’s Application for Provisional Release, 25 March 2009 (“Response to Motion for Provisional Release”)/Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm, 25 mars 2009 (“Përgjigje ndaj Mocionit për Lirim të Përkohshëm”).

⁷ *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve.*, Lënda Nr.IT-04-84-T, Vendim në lidhje me Kërkesën e Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm, 25 maj 2009 (“Vendim Miratues i Lirimit të Përkohshëm”), para 18.

⁸ Vendim Miratues i Lirimit të Përkohshëm, para 18(d).

⁹ Vendim Miratues i Lirimit të Përkohshëm, para 18(e)(i).

përkohshëm.¹⁰ Brahimaj u lirua përkohësisht më 28 maj 2009.¹¹ Që prej kësaj date Dhoma e Apelit ka marrë raporte javore prej Misionit EULEX për Kosovën, ku konfirmohet se Brahimaj i ka respektuar kushtet e lirimt të përkohshëm.

II. LIGJI PËRKATËS

4. Bazuar në Rregullën 65(I) të Rregullores një individ i shpallur fajtor mund të paraqesë kërkesë duke kërkuar lirim të përkohshëm për një periudhë të përcaktuar. Duke marrë në konsideratë Rregullën 107 të Rregullores, Rregulla 65 në tërësi zbatohet *mutatis mutandis* në lidhje me kërkesat e paraqitura Dhomës së Apelit sipas kësaj dispozite.¹² Rrjedhimisht Rregulla 65(I) parashtron se Dhoma e Apelit mund të miratojë lirim të përkohshëm në qoftë se bindet se: (i) nëqoftëse lirohet, personi i shpallur fajtor do të paraqitet në seancën e apelit, ose do të dorëzohet në paraburgim në përfundim të periudhës së përcaktuar, sipas rastit; (ii) nëqoftëse lirohet, personi i shpallur fajtor nuk do të përbëjë rrezik për viktimë, dëshmitarë apo persona të tjetër; dhe (iii) ekzistojnë rrethana të veçanta që përligjin lirimin. Këto kushte duhen shqyrtuar bashkërisht.¹³ Dhoma e Apelit rikujton se “plotësimi i këtyre kushteve prej kërkuesit përcaktohet duke u bazuar në tërësinë e gjasave, dhe gjatë vlerësimit të gjasave Dhoma e Apelit duhet të marrë gjithashtu parasysh faktin se individit tashmë është dënua”.¹⁴ Së fundi vlerësimi i plotësimt të kushteve të Rregullës 65 të Rregullores sipas gjykimit të Dhomës së Apelit, bëhet rast pas rasti.¹⁵

¹⁰ Motion Providing Mr. Brahimaj’s Address for Provisional Release Following Appeal Chamber Order [*sic*] of the 25 May 2009, 27 May 2009/Mocion që Komunikon Adresën e Z. Lahi Brahimaj gjatë Lirimt të Përkohshëm në Përgjigje të Urdhërësës së Dhomës së Apelit [*sic*] të 25 majit 2009, 27 maj 2009.

¹¹ Kërkesë, para. 12.

¹² *Prosecutor v. Milan Milutinović et al.*, Case No. IT-05-87-A, Decision on Vladimir Lazarević’s Motion for Temporary Provisional Release on the Grounds of Compassion, 2 April 2009, (confidential) (“*Lazarević Decision*”), para. 4; *Prosecutor v. Ljube Bošković and Johan Tarčulovski*, Case No. IT-04-82-A, Decision on Johan Tarčulovski’s Motion for Provisional Release, 18 December 2008, (confidential) (“*Tarčulovski Decision*”), para. 3; *Prokurori k. Millan Milutinoviçit dhe të tjerëve.*, Lënda Nr. IT-05-87-A, Vendim në lidhje me Mocionin e Vladimir Lazareviçit për Lirim të Përkohshëm të Kushtëzuar për Arsye Humanitare, 2 prill 2009 (konfidencial) (“*Vendimi Llazareviç*”), para 4. *Prokurori k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit.*, Lënda Nr. 04-82-T-A, Vendim në lidhje me Mocionin e Johan Tarçulovskit për Lirim të Përkohshëm, 18 dhjetor 2008, (konfidencial) (“*Vendimi Tarçulovski*”), para 3.

¹³ *Vendimi Llazareviç*, para 4; *Vendimi Tarçulovski*, para 3; *Prosecutor v. Dragomir Milošević*, Case No. IT-98-29/1-A, Decision on Application for Provisional Release Pursuant to Rule 65(I), 29 April 2008, (confidential) (“*Milošević Decision*”), para. 3/ *Prokurori kundër Dragomir Millosheviçit*, Lënda Nr. IT-98-29/1-A, Vendim në lidhje me Kërkesën për Lirim të Përkohshëm Sipas Rregullës 65(I), 29 prill 2008, (konfidencial) (“*Vendimi Millosheviç*”), para 3.

¹⁴ *Vendimi Llazareviç*, para 4; *Vendimi Tarçulovski* para 3; *Vendimi Millosheviç*, para 3.

¹⁵ *Vendimi Llazareviç*, para 4; *Prosecutor v. Pavle Strugar*, Case No. IT-01-42-A, Decision on Defence Request Seeking Provisional Release on the Grounds of Compassion, 2 April 2008, Public Redacted Version (“*Strugar Decision* of 2 April 2008”), para. 11, referring to *Prosecutor v. Jadranko Prlić et al.*, Case No. IT-04-74-AR65.5, Decision on Prosecution’s Consolidated Appeal Against Decisions to Provisionally Release the Accused Prlić, Stojić, Prajak, Pečković and Čorić, 11 March 2008, para. 7. *Prokurori k. Pavle Strugarit*, Lënda Nr. IT-01-42-A, Vendim në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes ku Kërkohe Lirim i Përkohshëm për Arsye Humanitare, 2 prill 2008, Versioni Publik i Redaktuar (“*Vendimi Strugar* i 2 prillit 2008”), para 11 që i referohet *Prokurori k. Jadranko Përlitit dhe të tjerëve.*, Lënda Nr. IT-04-74-AR65.5, Vendim mbi Apelin Përmbledhës të Prokurorisë Kundër Vendimeve për Lirimin e Përkohshëm të të Akuzuarve Përlit, Stojiç, Praljak, Pečkoviç dhe Qoriç, 11 mars 2008, para. 7

III. DISKUTIM

A. Argumentet e Palëve

5. Brahimaj kërkon ndryshimin e kushteve të lirimimit të përkohshëm, që të lejohet të udhëtojë për në komunat e Gjakovës dhe Deçanit së paku një herë në javë, në konsultim me Misionin EULEX për Kosovën, për të parë bashkëshorten dhe fëmijët e tij në Jabllanicë, komuna e Gjakovës, motrën e tij në Gllogjan, komuna e Deçanit, dhe vëllanë e tij në Gjakovë, komuna e Gjakovës.¹⁶ Brahimaj parashtroi se kur miratoi lirimimin e tij të përkohshëm, Dhoma e Apelit u bind se ai nuk përbënte rrezik arratisjeje dhe nuk do të rrezikonte viktimat, dëshmitarë apo persona të tjerë në përputhje me Rregullën 65(I)(i) dhe (ii) të Rregullores.¹⁷ Brahimaj argumenton se duke marrë parasysh këtë përfundim, ai duhet lejuar të udhëtojë jashtë komunës ku banon gjatë lirimimit të përkohshëm. Konkretisht Brahimaj argumenton se në shqyrtimin e Kërkesës së tij duhet zbatuar parimi i proporcionalitetit duke balancuar çfarëdo rreziku që ai ende mund të paraqesë, me të drejtën e tij për jetën e tij private dhe familjare.¹⁸

6. Prokuroria kundërshton Kërkesën me arsyetimin se Brahimaj nuk provon domosdoshmërinë për ndryshimin e kushteve të lirimimit të përkohshëm përcaktuar prej Dhomës së Apelit.¹⁹ Prokuroria kujton se në Vendimin Miratues të Lirimimit të Përkohshëm Dhoma e Apelit nuk miratoi kërkesën e Brahimajt që të lirohej “brenda territorit të Kosovës”, por përcaktoi që Brahimaj “të qëndrojë brenda kufijve të komunës ku banon” duke marrë parasysh shqetësimin e Prokurorisë lidhur me praninë e tij në gjyq dhe frikësimin e dëshmitarëve.²⁰ Prokuroria i ka përsëritur këto shqetësime në Përgjigje duke nënvizuar se kërkoji rigjykimin e Brahimajt²¹ dhe se frikësimi i dëshmitarit në procesin gjyqësor “është pika kyçe e apelimit të Prokurorisë” dhe mbetet rrezik i mundshëm në këtë çështje.²² Së fundi, Prokuroria argumenton se Brahimaj nuk ofron justifikim bindës në mbështetje të kërkesës së tij, meqë ai nuk shpjegon arsyen e pamundësisë së familjarëve së tij të përmendur në Kërkesë, për ta vizituar atë në komunën e zgjedhur prej tij, apo pse ai fillimisht vendosi që të banojë në një komunë të ndryshme nga bashkëshortja dhe fëmijët e tij.²³

¹⁶ Kërkesë, para 1, 15, 17.

¹⁷ Kërkesë, para 9-1, 9-2.

¹⁸ Kërkesë, para 16; shih edhe para 14, që i referohet *Prokurori k. Limajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-03-66-AR65, Vendim në lidhje me Kërkesën e fatmir Limajt për Lirim të Përkohshëm, 31 tetor 2003, para.10.

¹⁹ Përgjigje, para.1.

²⁰ Përgjigje, para.2. (citimet e brendshme nuk janë përfshirë)

²¹ Përgjigje, para.3.

²² Përgjigje, para.3; shih edhe Përgjigje ndaj Mocionit për Lirim të Përkohshëm, para 3, 6.

²³ Përgjigje, para.4.

7. Brahimaj kundërpërgjigjet se Prokuroria keqinterpretonte Vendimin Miratues të Lirimit të Përkohshëm. Sipas mendimit të Brahimajt, Dhoma e Apelit nuk gjykoj se ai përbën rrezik arratisjeje apo rrezik për viktima dhe dëshmitarë dhe përcaktoi kushtet e lirimit të përkohshëm mbi bazën e kushteve të lirimit të tij të mëparshëm gjatë procesit gjyqësor.²⁴ Më tej Brahimaj pretendon se pikëpamja e Prokurorisë se vizitat e tij te familjarët e tij më të afërt një herë në javë përbëjnë rrezik arratisjeje, është “e pabazë”.²⁵ Konkretisht Brahimaj konstaton se ai u lejua prej Dhomës së Apelit për të banuar në një komunë të zgjedhur prej tij në Kosovë, se ai nuk vëzhgohet aktivisht gjatë lirimit të përkohshëm, dhe se ai takohet çdo javë në banesën e tij me përfaqësuesit e Misionit EULEX për Kosovën.²⁶ Brahimaj pretendon se në këto rrethana Prokuroria nuk ka shpjeguar se në çfarë mënyre vizita një herë në javë e familjarëve të afërt krijon rrezik arratisjeje ose ndërhyrje ndaj dëshmitarëve.²⁷ Brahimaj deklaron se familja e tij e ka të vështirë ta vizitojë për shkak të moshës shumë të vogël të katër fëmijëve të tij dhe traditës shqiptare ku udhëtimi i grave të pashoqëruara nuk shihet me sy të mirë.²⁸ Ai argumenton se nuk duhet detyruar të zgjedhë midis jetesës me bashkëshorten dhe fëmijët në një “fshat të vogël” apo “përpjekjes për rifillimin e jetesës në Prishtinë[*sic*], por të pengohet të vizitojë familjen e tij”.²⁹

B. Analizë

8. Sic u rikujtua më sipër,³⁰ përcaktimi i përmbushjes së kushteve të Rregullës 65(I) të Rregullores përcaktohet prej tërësisë së gjasave dhe vlerësimet e këtyre kushteve sipas gjykimit të Dhomës së Apelit, bëhen rast pas rasti.³¹ Përcaktimi prej Dhomës së Apelit që nëqoftëse lirohet, i akuzuari nuk do të arratiset dhe nuk do të rrezikojë viktima, dëshmitarë apo persona të tjerë siç kërkohet prej Rregullës 65(I)(i) dhe (ii) të Rregullores,³² nuk është i shkëputur prej përcaktimit dhe shqyrtimit të kushteve të lirimit të përkohshëm që do të vendosen në lidhje me një rast konkret. Në fakt, konkluzioni se kushtet e Rregullës 65(I)(i) dhe (ii) janë plotësuar, është domosdoshmërisht i lidhur me kushtet e nevojshme për një vendim miratues të lirimit të përkohshëm. Rrjedhimisht, për shembull shqetësimet që kanë të bëjnë me faktin se i akuzuari mund të përbëjë rrezik arratisjeje, mund të gjejnë përgjigje

²⁴ Kundërpërgjigje, para 4, 7.

²⁵ Kundërpërgjigje, para 1, 8.

²⁶ Kundërpërgjigje, para 8.

²⁷ *Po aty*.

²⁸ Kundërpërgjigje, para 9.

²⁹ Kundërpërgjigje, para 10.

³⁰ *Më sipër*, para 4.

³¹ Vendimi *Llazareviq*, para 4;

³² Vendimi *Strugar* i 2 prillit 2008, para 11.

nëpërmjet vendosjes së një regjimi të rreptë vëzhgimi ndaj të akuzuarit.³³ Konkluzioni nëse kushtet e liritimit të përkohshëm janë të mjaftueshme për përmbushjen e kushteve të Rregullës 65(I)(i) dhe (ii) të Rregullores, varet prej rrethanave konkrete të çdo rasti dhe i lihet gjyqimit të Dhomës së Apelit.

9. Dhoma e Apelit kujton se në Vendimin e saj Miratues të Liritimit të Përkohshëm, ajo refuzoi kërkesën e Brahimajt lidhur me kushtet e liritimit të tij të përkohshëm.³⁴ Konkretisht Dhoma e Apelit gjyqoi se dy kushtet e sugjeruara prej Brahimajt, përkatësisht se ai do të qëndronte brenda territorit të Kosovës dhe do të paraqitej një herë në muaj te autoritetet vendore, ishin të pamjaftueshme për fashitjen e shqetësimeve të ngritura prej Prokurorisë lidhur me praninë e tij në gjyq dhe frikësimin e dëshmitarëve.³⁵ Në përgjigje të këtyre shqetësimeve, Dhoma e Apelit ndër të tjera, vendosi kushtin që gjatë liritimit të përkohshëm, Brahimaj të qëndrojë brenda kufijve të komunës ku banon.³⁶ Dhoma e Apelit rrëzon argumentin e Brahimajt se lejimi që ai të udhëtojë në Kosovë nuk ndikon kushtet e para për miratimin e liritimit të përkohshëm përcaktuar prej Rregullës 65(I)(i) dhe (ii) të Rregullores, duke qenë se kufizimi i lëvizjes është garanci kundër rrezikut të arratisjes së të akuzuarit ose rrezikut të paraqitur ndaj viktimave dhe dëshmitarëve.

10. Për më tepër, Dhoma e Apelit gjykon se Brahimaj nuk ka dhënë justifikim bindës pse nuk është në gjendje ta vizitojë familja në komunën ku banon, që ka zgjedhur vetë. As fakti i pretenduar prej Brahimajt se në traditën shqiptare nuk shihet me sy të mirë udhëtimi i grave të vetme, as mosha shumë e vogël e fëmijëve të tij³⁷ nuk mund të konsiderohen justifikim i mjaftueshëm për të lejuar ndryshim të kushteve të liritimit të përkohshëm të Brahimajt dhe t'i mundësojë atij lëvizje të pakufizuar. Për më tepër Brahimaj nuk ka deklaruar ndonjë arsye pse vëllai apo motra e tij nuk mund të udhëtojnë për ta vizituar.

11. Dhoma e Apelit kujton se Brahimajt iu dha mundësia të zgjidhte komunën ku do të banonte gjatë liritimit të përkohshëm.³⁸ Arsyeja pse Brahimaj zgjodhi të banonte në Prishtinë

³³ *Prosecutor v. Milan Lukić and Sredoje Lukić*, Case No. IT-98-32/I-A, Decision on Milan Lukić's Motion for Provisional Release, 29 August 2009, p.5, note 32./*Prokurori kundër Millan Lukiqit dhe Sredoje Lukiqit*, Lënda Nr. IT-98-32/I-A; *Prosecutor v. Milan Milutinović et al.*, Case No. IT-05-87-A, Public Redacted Version of the "Decision on Vladimir Lazarevi's Second Motion for Temporary Provisional Release on the Grounds of Compassion, issued on 21 May 2009, 22 May 2009, para. 14-15, 17(5)(c)./ *Prokurori k. Milan Milutinoviqit dhe të tjerëve.*, Lënda Nr. IT-05-87-A, Version Publik i Redaktuar i "Vendimit në lidhje me Mocionin e Dytë të Vladimir Llazareviqit për Lirim të Përkohshëm të Kushtëzuar për Arsye Humanitare, lëshuar më 21 maj 2009, 22 maj 2009, para. 14-15, 17(5)(c).

³⁴ Vendim Miratues i Liritimit të Përkohshëm, para 17.

³⁵ Mocion për Lirim të Përkohshëm, para 17; Vendim Miratues i Liritimit të Përkohshëm, para 17.

³⁶ Vendim Miratues i Liritimit të Përkohshëm, para 18(e)(i).

³⁷ Kundërpërgjigje, para 9.

³⁸ Vendim Miratues i Liritimit të Përkohshëm, para 18(d)(e).

dhe jo me familjarët e tij gjatë periudhës së lirimit të përkohshëm, nuk hyn në kompetencën e Dhomës së Apelit. Gjithsesi, bazuar në informacionin e dhënë në Kërkesë, Dhoma e Apelit e gjykon të përshtatshme ta lejojë Brahimajn t'u bëjë të ditur autoriteteve të Misionit EULEX për Kosovën dhe Sekretarit të Tribunalit, një adresë të re dhe të ndryshme në Kosovë ku ai do të zhvendoset, brenda tri ditësh prej lëshimit të këtij Vendimi. Në rast se Brahimaj zgjedh një vendbanim të ri, ai do të shkojë atje i shoqëruar prej një përfaqësuesi të Misionit EULEX për Kosovën, brenda katërbëdhjetë ditësh prej lëshimit të këtij Vendimi dhe të qëndrojë në vendbanimin e ri deri në mbarimin e lirimit të përkohshëm. Të gjitha kushtet e tjera të Vendimit Miratues të Lirimit të Përkohshëm mbeten të pandryshuara.

IV. VENDIM

12. Për arsyet e lartpërmendura, bazuar në Rregullën 65(I) të Rregullores, Dhoma e Apelit:

RRËZON Kërkesën;

URDHËRON që nëqoftëse Brahimaj dëshiron të zhvendoset brenda Kosovës, ai t'u bëjë të ditur autoriteteve të Misionit EULEX për Kosovën dhe Sekretarit të Tribunalit adresën e re në Kosovë, brenda tri ditësh pas lëshimit të këtij Vendimi;

KËRKON që nëqoftëse Brahimaj vendos të ndryshojë vendbanimin, Misioni EULEX për Kosovën:

- i. ta shoqërojë Brahimajn në vendbanimin e ri brenda katërbëdhjetë ditësh pas lëshimit të këtij Vendimi; dhe
- ii. t'i dërgojë Dhomës së Apelit një raport në lidhje me transferimin e Brahimajt në vendbanimin e tij të ri brenda dy ditësh pas datës së transferimit

URDHËRON që të gjitha kushtet e lirimit të përkohshëm të Brahimajt të përcaktuara në Vendimin Miratues të Lirimit të Përkohshëm të mbeten në fuqi.

Përpiluar në anglisht dhe frengjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nëshkruar në origjinal/
Gjykatës Patrick Robinson
Kryegjykatës

Sot, më datën 2 shtator 2009.
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]